

# **TAKIM DISKUTIMI : "MBI ECURINË E SISTEMIT BANKAR NË SHQIPËRI DHE TË PROCESIT TË PRIVATIZIMIT TË BANKAVE SHTETËRORE."**

## **FJALA E HYRJES**

Të nderuar pjesëmarrës !

Duke ju falenderuar që ju përgjigjet ftesës tonë për të marrë pjesë në këtë takim uroj, gjithashtu, edhe pjesëmarrjen tuaj aktive në të.

Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave, si dy autoritetet kryesore financiare dhe monetare të vendit, organizojnë sot takimin me temë "Ecuria e sistemit bankar dhe procesi i privatizimit të bankave shtetërore" me një pjesëmarrje të gjerë specialistësh të kësaj fushe nga ambientet universitare, institutet e ndryshme që veprojnë në fushën e studimeve ekonomike, autoritetet qeveritare, bota e biznesit, përfaqësues të shoqërisë civile etj. me synimin për t'ia nënshtruar këtë proces një debati të hapur e konstruktiv, pa paragjykitime e spekulime dhe për të reflektuar gjithçka racionale, që arrihet nëpërmjet këtyre aktiviteteve në procesin e vendimmarrjes.

Reforma në sistemin bankar, si një element mjaft i rëndësishëm i reformave strukturore është ndeshur gjatë këtyre 10 viteve të tranzicionit me mjaft sfida e vështirësi. Nuk mjaftuan kushtet e disfavorshme nga pikëpamja makroekonomike në të cilat filloi kjo reformë si: rënie drastike e prodhimit, deficit buxhetor, shterje e rezervave valutore, deficit në bilancin e pagesave, prapambetje në zhvillimin e institucioneve bankare, por ajo u përball edhe me mjaft vështirësi të brendshme të saj, që buronin nga rritja e vazhdueshme e kredive të këqija, mungesa e eksperiencës në fushën e mbikëqyrjes bankare, ineficienca e sistemit të pagesave etj., vështirësi të cilat arritën kulmin me krizën e piramidave, e cila shërbeu si një shkëndijë, që destabilizoi

gjithë vendin dhe e futi ekonominë shqiptare në një kolaps të plotë.

Qëllimi i këtij takimi është i dyfishtë.

Së pari, të analizojë procesin e reformës në fushën e sistemit bankar, gjendjen aktuale dhe perspektivat e tij si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë së tregut dhe së dyti, të fokusohet në mënyrë të veçantë në problemet, që lidhen me privatizimin e Bankës së Kursimeve.

Serioziteti me të cilin i trajtojnë autoritetet përkatëse këto probleme buron nga rëndësia dhe roli, që luan sistemi bankar për grumbullimin dhe shpërndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e tregjeve financiare, stabilitetin makroekonomik, zbatimin me efikasitet të politikave monetare e fiskale, të cilat në instancë të fundit, mbështesin zhvillimin e shpejtë ekonomik të vendit.

Edhe pse optika e trajtimit të këtyre çështjeve nga referuesit kryesorë është e ndryshme dhe buron nga detyrat e institucioneve në një shtet ligjor, këto diskutime konvergojnë në qëllimin final të tyre, realizimin me sukses të fazës finale të reformës në sistemin bankar, që është privatizimi dhe krijimi i një sistemi bankar të shëndoshë, të sigurt, konkurrues dhe eficient, të aftë për t'i ofruar publikut shqiptar produkte të standardeve ndërkombëtare të bankingut modern, të përballojë rreziqet komplekse që shoqërojnë ekonominë e tregut dhe të mbështesë programin e Qeverisë Shqiptare për rimëkëmbjen e shpejtë ekonomike të vendit.

Ju faleminderit !

**Fatos Ibrahimi**

**Zëvendësguvernator i Parë**